



Prishtinë, 15.10.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1047_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 26 paragrafi 1, nenit 47 dhe nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 18 dhe nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike; dhe
- Shkresën e Ndërmarrjes Publike – Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova sh.a. të datës 20 shtator 2018.

Pas shqyrtimit të shkresës dhe bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë 15 tetor 2018, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHEN** tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë të Ngrohtores së Qytetit (NQ) Gjakova sh.a. për sezonin e ngrohjes 2018/2019, siç janë paraqitur në tabelën 'II.1', që do të zbatohen nga data 15 tetor 2018.

Arsyetim

1. Me datën 20 shtator 2018, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar shkresën nga Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova SH. A, me anë të së cilës ZRRE njoftohet për arsyet që pamundësojnë një aplikim të kompletuar dhe të bazuar në parashikime reale, për shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për sezonin. Arsyet e cekura në shkresë përmbledhen në vijim:
 - NQ Gjakova, edhe në këtë sezon, për prodhimin e energjisë termike do të bazohet në lëndën djegëse mazut, që paraqet një kosto të papërballueshme financiare për ndërmarrjen;
 - Duke marrë parasysh këtë dhe gjendjen aktuale të vështirë financiare, operimi i NQ Gjakova do të jetë në masë të madhe i varur nga subvencionet prej Buxhetit të Kosovës – për vitin kalendarik 2018 janë siguruar subvencionet ndërsa shpresohet se do të sigurohet një shumë e mjaftueshme edhe për vitin 2019.
 - NQ Gjakova është përfituese e projektit në vlerë prej rreth 12 milion Euro të financuar nga BE për ndërtimin e ngrohtores së re me biomasë, që është në fazën finale përgatitore – të përzgjedhjes së kontraktit për ekzekutimin e punimeve; realizimi i këtij projekti do mundësojë që në të ardhmen të ofrohet furnizim i pandërprerë dhe kualitativ. Sidoqoftë deri në realizimin e tij NQ Gjakova do përpiqet të mbajë vazhdimësinë e operimit dhe të ofroj furnizim brenda mundësive të limituara financiare, ashtu që gradualisht të rikthejë besimin e konsumatorëve.



- Shkaqet e theksuara më lartë vështirësojnë çdo planifikim (parashikim) real dhe mjaftueshëm të saktë për një shqyrtim të mirëfilltë tarifor.
2. Bordi i ZRRE ka marr parasysh arsyetimet e paraqitura në shkresën e NQ Gjakova, të cilat i ka konsideruar të drejta dhe të argumentuara.
 3. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e shkresës së NQ Gjakova të datës 20.09.2018, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakova sh.a. për sezonin e ngrohjes 2018/2019 është dhënë në tabelën II.1 më poshtë.

Tabela II.1: Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakova sh.a. – sezoni 2018/2019

TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE TË NQ GJAKOVA - Sezoni 2018/2019			
A: TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE ME MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera	
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.91	
Tarifa për Furnizim /Konsum të En. Term. (Komp. variabile)	[€/MWh]	58.76	
B: TARIFAT E ENERGJISË TERMIKE PA MATJE			
Komponentët e tarifës	Njësia	Konsumat. shtëpijak	Konsumat. Kom&Inst.
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m ² për muaj]	0.09	0.12
Tarifa për Furnizimin /Konsumin e En. Term. (komp. variabile)	[€/m ² për muaj]	0.88	1.27
Tarifa totale për konsumatorët pa matje	[€/m ² për muaj]	0.97	1.39

- III. NQ Gjakova sh.a. duhet ta publikoj strukturën e tarifave të energjisë termike siç është përcaktuar në tabelën II.1 të këtij Vendimi, brenda pesë (5) ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim më të gjerë në Kosovë.
- IV. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Gjakova, për të verifikuar realizimin e të hyrave dhe kostove të realizuara në sezonin 2018/2019.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga NQ Gjakova nga data 15 tetor 2018 gjer në shqyrtimin e ardhshëm tarifor; ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d.Kryesues i Bordit

Besim Sejfiqaj, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Izet Rushiti, Anëtar

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së